



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**VENDIM**

Nr.116, datë 18.07.2024

**PËR**

**“CAKTIMIN E ZONJËS ODETA TODORUSHI NË DETYRËN E  
PROKURORIT NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS  
SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM LEZHË, NËPËRMJET  
PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE”**

Mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës, nenin 90, pika 2 të “Kodit të Procedurave Administrative”, nenin 41 dhe 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164, pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 44 dhe 45 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të paraqitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Caktimin e zonjës Odeta Todorushi në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në pozicionin vakant Nr. 2 shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.13, datë 16.02.2024.
2. Marrëdhëniet financiare që lidhen me pagën dhe përfitimet e tjera do të përballohen nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë duke filluar nga data 02.09.2024.
3. Relacioni i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Odeta Todorushi, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.
5. Ky vendim hyn në fuqi më 18.07.2024 dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 18.07.2024.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**



**KRYETAR**  
Mirela Bogdani

**ANËTAR**  
Sokol Stojani


**ANËTAR**  
**Zeqir Hoda**




**ANËTAR**  
**Moisi Duda**



**ANËTAR**  
**Arta Mandro**



**ANËTAR**  
**Olger Eminaj**



**ANËTAR**  
**Ledina Riza**

